

Krahasim: Metoda katër-shkallëshe / Metoda e përpunimit

Metoda katër-shkallëshe	Metoda e përpunimit të mësimit praktik
<p>1. Përgatitja dhe motivimi i nxënësit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Parakushtet për mësim, ndër tjera përcaktimi i njohurive dhe përvojës - Zgjidhja e interesimit dhe motivimi - Këshilla lidhur me qëllimet dhe detyrat - Njohja me vendin punës, me ndërrmarje të masave të informohen mbi parandalimin e lëndimeve 	<p>1. Faza përgatitore</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dhënia e detyrës dhe ndërlidhja e saj me shkollën (çka është përpunuar më parë dhe çka vie më pas) - Të pyetet domethënia për punë dhe për ndërrmarje, në rast nevojë dhënia e këshillave lidhur me detyrën - Përcaktimi i njohurive dhe përvojave paraprake (p.sh. vërejtjet në situatat konkrete të punës), nëse është nevojë të shikohet vërtetimi lidhur me shkollën e ndërlidhur me punën konkrete - Këshillimi lidhur me rreziqet e lëndimit respektivisht ndërmjetësimi i tyre bashkë me nxënësit
<p>2. Demonstrimi dhe sqarimi</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nxënësi duhet të qëndrojë në drejtim të njëjtë sikurse mësuesi - Të demonstronhet i tërë procesi në tempo origjinale dhe në lidhshmëri - Rastet e komplikuar të punës të ndahen në pjesë dhe të demonstronhen njëra pas tjetrës - Përsëritje e demonstrimit me heqje (shkarkim) të artë të hapave të veçantë të punës me një tempo më të ngadalsuar - Gjatë sqarimit të hapave të punës të definohen pikat kyçe - Dhënia e mundësisë që nxënësi të prashtojë pyetje 	<p>2. Faza e përpunimit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pozicionimi i drejtë i nxënësit për të zhvilluar punën - Të pyetet nxënësi lidhur me ecurinë e punës dhe të kërkohen sqarime (si mund të veprojmë? Pse mu në këtë mënyrë?); gjatë kësaj kohe duhet bashkarisht të përpunohen masat për parandalimin e fatkeqësive - Në disa hapa të punës ti lejohet nxënësit të tentojë punë të pavarur - Me rëndësi: Tek veprimet e rrezikshme të jipen udhëzime të qarta ose të demonstronhen hapa të ndryshëm të punës - Nëse është nevojë të jipen këshilla korigjuese, por kryesisht nxënësi të lihet të punojë i pavarur
<p>3. Të lejohen përpjekjet për realizim</p> <ul style="list-style-type: none"> - Metoda e përpunimit të mësimit praktik - Inkurajimi i nxënësit për përpjekje vetanake - Gjatë përpjekjeve të para nxënësi nuk duhet ndërprerë përmes ndonjë kritike apo korigjimi, në mënyrë që të mos dekurajohet - Të udhëzohet mbi gabimet e përgjithshme - Të mos lejohet punë tepër e shpejtë; Saktësia në punë ka përparësi ndaj shpejtësisë - Të lejohet nxënësi që me fjalët e veta të sqarojë se pse dhe si është duke kryer diçka 	<p>3. Faza e kontrollimit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nxënësit ti lejohet vetëvlerësimi i punës së tij, nëse nevojitet të përpunohen bashkarisht kriteret e vlerësimit apo pjesërisht të paracaktohen - Të lejohet përmbledhja e pikave kyçe thelbësore nga ana e nxënësit - Në rast nevojë të parashtrihen pyetje shtesë për të kuptuar lidhshmëritë
<p>4. Të ushtruarit dhe forcimi</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të ofrohen mundësi të bollshme për ushtrime - Përparimet në ushtrime të kontrollohen dhe të pranohen - Të kihet kujdes që të mos vjen deri tek përvjedhja e gabimeve gjatë ushtrimeve - Variabiliteti i kushteve të ushtrimeve - Përshtatja graduale në kushtet reale të punës (p.sh. Shpejtësia) 	<p>4. Faza e ushtrimit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pas përfundimit të mësimit praktik, nxënësit ti parashtrihen detyra në formë të ushtrimeve konkrete; me këtë rast duhet të ndryshojnë kushtet e ushtrimeve - Të analizohen rezultatet e ushtrimeve dhe të kihet kujdes që të mos ngulitet ndonjë gabim - Nxënësit ti jipet mundësia e aplikimit të të mësuarit të ndonjë porosie